

Testi që po publikojmë, është një nga variantet e zhvilluara në provimin e **Historisë** për Maturën Shtetërore 2020.

Të gjitha variantet kanë pyetje të njëjta, por renditja e tyre ndryshon në çdo variant.

Në variantin e dhënë më poshtë alternativat e sakta janë **të theksuara**.

1. Cili nga qytetërimet e mëposhtme është i njohur për lindjen e demokracisë? 1 pikë
A) Egjipti;
B) Greqia;
C) Kina;
D) Roma.
2. Cili fis ilir shtrihej në territorin e Kosovës së sotme? 1 pikë
A) Amantët.
B) Dardanët.
C) Desaretët.
D) Taulantët.
3. Lufta e Peloponezit u zhvillua midis: 1 pikë
A) Spartës dhe Athinës;
B) Spartës dhe Mikenës;
C) Athinës dhe Persisë
D) Athinës dhe Romës.
4. Bëri reformën territoriale në Greqinë e lashtë: 1 pikë
A) Drakoni;
B) Klisteni;
C) Perikliu;
D) Soloni.
5. Periudha që u quajt si "Paqja Romake" (Pax Romana), përkon me qeverisjen e: 1 pikë
A) Oktavianit;
B) Pompeit;
C) Çezarit;
D) Antonit.
6. Perandoria Romake u nda në dy pjesë në vitin: 1 pikë
A) 195
B) 295
C) 395
D) 495
7. Rruga Egnatia filloi të ndërtohet në periudhën kur: 1 pikë
A) nisi Lufta I iliro – romake;
B) Pirroja ishte në krye të shtetit të Epirit;
C) në Mbretërinë Ilire sundonte mbreti Agron;
D) trojet ilire u vendosën nën pushtimin romak.
8. Cili nga pohimet e mëposhtme është pasojë e zbulimeve gjeografike? 1 pikë
A) Bllokimi i rrugëve tregtare drejt Lindjes së Largët si pasojë e pushtimeve të turqve osmanë.
B) Krijimi i perandorive koloniale dhe ndryshimi i qendrës së tregtisë botërore.
C) Zhvillimi i qytetërimeve vendase të Amerikës Jugore.
D) Lindja dhe përhapja e ideve të Rilindjes.
9. Hodhi themelet e shtetit unitar mesjetar, principata e: 1 pikë
A) Zenebishëve;
B) Muzakajve;
C) Balshajve;
D) Topiajve.

10. Cili sistem ekonomik ekzistonte në Francë gjatë periudhës së Mesjetës? 1 pikë
- A) Skllavopronaria.
B) **Feudalizmi.**
C) Kapitalizmi.
D) Socializmi.
11. Cili nga dokumentet e mëposhtëm vendosi parimin e monarkisë së kufizuar në Angli? 1 pikë
- A) Deklarata e Pavarësisë.
B) Akti i Supremacisë.
C) **Magna Karta.**
D) 12 Tabelat.
12. Çfarë solli miratimi i Dekreti Fontenëblo nga Luigji XIV në vitin 1685, në Francë? 1 pikë
- A) **Shkatërrimin e kishave protestante dhe mbylljen e shkollave të tyre.**
B) Harxhimin e shumave të mëdha të parave për ndërtimet luksoze.
C) Humbjen e pushtetit për shtresën e fisnikëve të vjetër.
D) Përkrahjen e lindjes së degëve të reja të industrisë.
13. Në shek XII, formacioni shqiptar, që mori tipare të qarta shtetërore ishte principata e: 1 pikë
- A) Zenebishëve;
B) Muzakajve;
C) Topiajve;
D) **Arbrit.**
14. Cili ishte sundimtari që pati më shumë sukses në Principatën e Topiajve? 1 pikë
- A) Tanush Topia.
B) **Karl Topia.**
C) Gjergj Topia.
D) Andrea Topia.
15. Me cilat shtete u fut në konflikt Prusia gjatë procesit të bashkimit të Gjermanisë? 1 pikë
- A) Franca, Anglia dhe Italia.
B) Austria, Italia dhe Anglia.
C) Danimarka, Belgjika dhe Franca.
D) **Danimarka, Austria dhe Franca.**
16. Një nga shkaqet e lindjes së Reformacionit ishte: 1 pikë
- A) **korupsioni që ekzistonte brenda kishës;**
B) thirrja e Këshillit të Trentos nga Papa Pali III;
C) miratimi i Aktit të Supremacisë në Angli;
D) revolta që ndodhi në Spanjë.
17. Filozofi anglez Xhon Loku argumentonte se jeta, liria dhe prona janë: 1 pikë
- A) të drejta politike që garantoohen nga ligji
B) të drejta ekonomike të garantuara nga sistemi kapitalist
C) të drejta sociale të garantuara nga klasa në pushtet
D) **të drejta natyrore që duhet të garantoehen nga qeveria**
18. Ndarja e të krishterëve në katolikë dhe protestantë ishte një nga rrjedhojat e: 1 pikë
- A) **reformacionit;**
B) Koncilit të Trentos;
C) zbulimeve gjeografike;
D) ndarjes së Perandorisë Romake.

19. Cili ishte revolucioni që vendosi përfundimisht epërsinë e parlamentit ndaj mbretit në Angli? 1 pikë
- A) Revolucioni i Tetorit.
B) Revolucioni I Industrial.
C) Revolucioni II Industrial
D) **Revolucioni i Lavdishëm.**
20. Një nga shkaqet kryesore të fillimit të Luftës Civile në SHBA ishte: 1 pikë
- A) përplasjet për territore midis SHBA dhe Meksikës;
B) përplasjet midis pushtetit civil dhe atij kishtar;
C) **lëvizja për heqjen e skllavërisë;**
D) vendosja e taksës së pullës.
21. Cila prej ideve të mëposhtme i përket iluministit Zhan Zhak Ruso? 1 pikë
- A) Kritika e klerikalizmit dogmatik;
B) **Vendosja e formës republikane të qeverisjes;**
C) Qeverisja e kufizuar në raport me të drejtat e njeriut;
D) Ndarja dhe pavarësia e pushteteve brenda një shteti.
22. Hartuesi kryesor i Deklaratës së Pavarësisë në SHBA (4 Korrik 1776), ishte: 1 pikë
- A) Xhon Adams;
B) **Tomas Xheferson;**
C) Xhorxh Uashington;
D) Aleksandër Hamilton.
23. Në cilin nga shtetet e mëposhtme lindi Revolucioni i Parë Industrial? 1 pikë
- A) Në Gjermani.
B) Në Francë.
C) **Në Angli.**
D) Në Itali.
24. Kufiri lindor i shtetit të Skënderbeut ishte deri në: 1 pikë
- A) vargun malor të Skënderbeut;
B) kufirin e sotëm me Kosovën;
C) **luginën e Drinit të Zi;**
D) luginën e Matit.
25. Pashallëku i Shkodrës e arriti kulmin e shkëlqimit të tij, nën qeverisjen e: 1 pikë
- A) Mehmet pashë Bushatlliu
B) **Mahmut pashë Bushatlliu**
C) Mustafa pashë Bushatlliu
D) Ibrahim pashë Bushatlliu
26. Shkolla e parë shqipe u hap në vitin 1887 në qytetin e: 1 pikë
- A) Elbasanit;
B) Shkodrës;
C) **Korçës;**
D) Vlorës.
27. Qëllimi i mbledhjes së Kongresit të Manastirit ishte: 1 pikë
- A) bashkimi i katër vilajeteve;
B) **çaktimi i një alfabeti të vetëm;**
C) hapja e një shkolle pedagogjike;
D) organizimi i një kryengritjeje të përgjithshme.

28. Kuvendi i Lezhës **NUK** vendosi për: 1 pikë
- A) për krijimin e shtetit të përqendruar;
 B) bashkimin e burimeve humane dhe financiare;
 C) caktimin e Skënderbeut si komandant të ushtrisë;
 D) krijimin e arkës me vetëfinancim nga bujarët shqiptarë.
29. Vendimet e Traktatit të Shën Stefanit nuk u pranuan nga Fuqitë e Mëdha për shkak: 1 pikë
- A) se pjesa më e madhe e Shqipërisë i kalonte Serbisë;
 B) se zgjerohej shumë territori i Perandorisë Osmane;
 C) të krijimit të një Bullgarie shumë të madhe;
 D) të daljes në Adriatik të Turqisë.
30. Çfarë nënkuptonte parimi i legjitimitetit i miratuar në Kongresin e Vjenës 1814-1815? 1 pikë
- A) Krijimin e disa "shteteve kushinetë", me qëllim frenimin e agresioneve ndaj Francës.
 B) Ndryshimin e hartës politike të Evropës pas periudhës së Napoleon Bonapartit.
 C) Fuqizimin e Francës dhe marrjen e rolit drejtues të saj në Evropë.
 D) Rikthimin në pushtet të familjeve të vjetra monarkike.
31. Lufta I Botërore filloi kur Austro – Hungaria i shpalli luftë: 1 pikë
- A) Britanisë së Madhe;
 B) Francës;
 C) Serbisë;
 D) Rosisë.
32. Pse Britania e Madhe, Franca dhe Rusia formuan Bllokun e Antantës? 1 pikë
- A) Për të zhvilluar një aleancë me baza ekonomike duke hapur tregje të përbashkëta.
 B) Për t'iu përgjigjur rritjes së fuqisë ushtarake të Bllokut Qendror.
 C) Për t'iu përgjigjur rritjes së fuqisë ushtarake të Japonisë.
 D) Për të shtypur pakicat kombëtare në vendet e tyre.
33. Cila nga shtetet fituese paraqiti planin prej 14 pikash në Konferencën e Paqes së Parisit (1919)? 1 pikë
- A) Britania e Madhe.
 B) Franca.
 C) Italia.
 D) SHBA-ja.
34. Cilën nga masat e mëposhtme ekonomike ndërmori Italia gjatë periudhës fashiste? 1 pikë
- A) Dha ndihma financiare për të lehtësuar papunësinë.
 B) Uli kontrollin e shtetit për bursën dhe në sistemin bankar.
 C) Shtetëzoi industrinë dhe bëri ndarjen e tokës për fshatarët.
 D) Rriti sipërfaqen e punëshme të tokës nëpërmjet bonifikimit.
35. Konsiderohet si themeluesi i shtetit totalitar komunist: 1 pikë
- A) Adolf Hitler;
 B) Benito Musolini;
 C) Vladimir Lenin;
 D) Francisko Franko.
36. Një nga tiparet karakteristike të diktaturave autoritare është: 1 pikë
- A) ndalimi i veprimtarive të partive të tjera politike;
 B) kontrolli dhe baraspeshimi i pushteteve;
 C) nxitja e veprimtarisë së sindikatave;
 D) respektimi i lirive të individit.

37. Gjatë Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1913), shtetet që mbështetën çështjen shqiptare ishin: **1 pikë**
- A) Austro-Hungaria dhe Gjermania;
 - B) Italia dhe Britania e Madhe;
 - C) **Austro-Hungaria dhe Italia;**
 - D) Gjermania dhe Franca.
38. Sipas Traktatit të Fshehtë të Londrës, Shqipëria: **1 pikë**
- A) **vendosej nën protektoratin italian;**
 - B) eliminohej tërësisht si entitet shtetëror;
 - C) fitonte territore në dëm të Perandorisë Osmane;
 - D) formohej si shtet duke bashkuar katër vilajetet shqiptare.
39. Rënia e perandorisë Osmane dhe asaj Austro – Hungareze ndikoi drejtpërsëdrejti në: **1 pikë**
- A) krijimin e Lidhjes së Kombeve;
 - B) **krijimin e shteteve të reja;**
 - C) zbatimin e Planit Marshall;
 - D) përhapjen e komunizmit.
40. Thelbi i Kursit të Ri të Ruzveltit ishte: **1 pikë**
- A) **rritja e rolit të shtetit në ekonomi;**
 - B) aplikimi i modelit sovjetik në ekonomi.
 - C) zvogëlimi i rolit të shtetit në ekonomi;
 - D) zëvendësimi i plotë i pronës private me atë shtetërore;
41. Cili nga shtetet e mëposhtme nuk nënshkroi asnjëherë traktatin e paqes në Konferencën e Paqes në Paris, pas Luftës II Botërore? **1 pikë**
- A) Italia.
 - B) Austria
 - C) Japonia
 - D) **Gjermania.**
42. Qëllimi kryesor i Bashkimit Sovjetik gjatë viteve të para të Luftës së Ftohtë ishte: **1 pikë**
- A) të tërhiqte investimet e huaja nga Evropa Perëndimore me qëllim zhvillimin e ekonomisë;
 - B) **të krijonte një zonë në Evropën Lindore që të shërbente si mbrojtje për vetë atë;**
 - C) të ngrinte një ekonomi konkurruese mbi bazën e tregut të lirë;
 - D) t'u jepte më shumë të drejta qytetarëve të republikave baltike.
43. Traktati i Varshavës u krijua në vitin 1955 si kundërpërgjigje për: **1 pikë**
- A) shpikjen e bombës me hidrogjen në SHBA;
 - B) fillimin e revolucionit komunist në Kubë;
 - C) ndërhyrjen e SHBA-së në Kore;
 - D) **krijimin e NATO-s.**
44. Cila nga reformat e mëposhtme u ndërmor gjatë qeverisjes së M. Theçerit në Britaninë e Madhe? **1 pikë**
- A) Rritja e taksave dhe bllokimi i rritjes së pagave dhe pensione.
 - B) **Shkurtimi i shpenzimeve publike, përveç atyre për mbrojtjen dhe rendin publik.**
 - C) Forcimi i rolit të shtetit në ekonomi dhe shtetëzimi i shumë sektorëve kyç të ekonomisë.
 - D) Krijimi i sistemit të kontributeve për sigurimet shoqërore dhe ai i Shërbimit Shëndetësor Kombëtar.

45. Cili ishte qëllimi i reformave Glasnost e Perestrojka të Mihail Gorbaçovit? 1 pikë
- A) Forcimi i rolit të Qeverisë Qendrore mbi republikat e tjera.
B) Rritja e kontrollit të Bashkimit Sovjetik në vendet e kampit komunist.
C) **Liberalizimi i jetës ekonomike dhe politike në BS.**
D) Rritja e censurës në shtypin e shkruar.
46. Cili prej shteteve të mëposhtme u shkëput me luftë nga sundimi kolonial francez? 1 pikë
- A) **Algjeria**
B) Maroku
C) Tunizia
D) Libia
47. Cila nga ngjarjet e mëposhtme shënoi fillimin e procesit të bashkimit midis dy Gjermanive? 1 pikë
- A) Zbatimi i të ashtuquajturës Ostpolitika.
B) Zbatimi i të ashtuquajturës Uestpolitika.
C) Ndërtimi i Murit të Berlinit.
D) **Rënia e Murit të Berlinit.**
48. Republikat e para që shpallën pavarësinë nga Bashkimi Sovjetik ishin: 1 pikë
- A) **Letoni, Lituani dhe Estoni;**
B) Moldavi, Gjeorgji dhe Ukrainë;
C) Kazakistan, Ukrainë dhe Armeni;
D) Bjellorusi, Ukrainë dhe Gjeorgji.
49. Bashkimi Evropian në fillimet e veta synonte të: 1 pikë
- A) **nxiste bashkëpunimin ekonomik mes shteteve evropiane;**
B) krijonte një forcë ushtarake të armatosur brenda Evropës;
C) mbështeste zhvillimin e ekonomive të centralizuara;
D) krijonte një forcë të përbashkët politike.
50. Vendimi i njohjes së Shqipërisë si: "*principatë autonome, sovranë e trashëgueshme*" nën garancinë e Fuqive të Mëdha u mor në: 1 pikë
- A) Kongresin e Berlinit;
B) Kongresin e Shën Stefanit;
C) Konferencën e Paqes në Paris;
D) **Konferencën e Ambasadorëve në Londër.**
51. Luajti një rol vendimtar në favor të Shqipërisë gjatë Konferencës së Paqes së Parisit (1919-1920): 1 pikë
- A) **Thomas Uidro Uilson;**
B) David Llojd Xhorxh;
C) Zhorzh Klemanso;
D) Vitorio Orlando.
52. Në statutin themeltar të Republikës së Shqipërisë së vitit 1925, presidenti ishte njëkohësisht kryeministër i vendit dhe kryetar i forcave të armatosura. Cili ishte qëllimi real i këtij organizimi institucional? 1 pikë
- A) **Forcimi i pushtetit politik të Ahmet Zogut.**
B) Shkëputja e Shqipërisë nga ndikimi ekonomik italian.
C) Të mos ndryshonte forma e regjimit nga republikë në monarki.
D) Arritja e balancimit të pushteteve në Republikën Shqiptare.

53. Pika e përbashkët e programeve të Partisë Komuniste dhe Ballit Kombëtar ishte: **1 pikë**
- A) rivendosja e formës monarkike të qeverisjes.
 - B) rivendosja e pavarësisë së Shqipërisë pas luftë.**
 - C) fillimi i veprimeve luftarake pas zbarkimit të aleatëve në Shqipëri.
 - D) bashkimi i Kosovës me Shqipërinë, në respekt të Kartës së Atlantikut.
54. Çlirimi i vendit në nëntor 1944, shënoi marrjen e pushtetit në Shqipëri nga qeveria komuniste e udhëhequr nga Enver Hoxha. Në këtë moment synohej njohja në arenën ndërkombëtare, sidomos nga Aleatët e Mëdhenj. Cili prej pohimeve të mëposhtme përbënte një prej kushteve për njohjen e qeverisë shqiptare? **1 pikë**
- A) Kryeja e reformës agrare në Shqipëri.
 - B) Zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 të ish-in të lira dhe demokratike.**
 - C) Dhënia e territoreve të Shqipërisë Jugore, shtetit fqinj Greqisë.
 - D) Amnistia për krerët e organizatave nacionaliste si Balli Kombëtar dhe Legaliteti.
55. Me cilin nga shtetet e mëposhtme Shqipëria nënshkroi një konventë ekonomike, që midis të tjerave përmbante bashkimin doganor dhe unifikimin e monedhës? **1 pikë**
- A) Jugosllavinë;**
 - B) Greqinë;
 - C) Turqinë;
 - D) Italinë.
56. Ndalimi me ligj i besimit fetar në Shqipëri, u sanksionua në kushtetutën e vitit: **1 pikë**
- A) 1925;
 - B) 1928;
 - C) 1946;
 - D) 1976.**
57. Shenjat e para të krizës së marrëdhënieve etnike në gjirin e Jugosllavisë federative, që do të çonte disa vite më vonë në shpërbërjen e saj, u dhanë në Kosovë. Cila ishte ngjarja që shërbeu si premisë për fillimin e kësaj krize? **1 pikë**
- A) Kërkesa për shpalljen e Kosovës republikë gjatë demonstratave të vitit 1981.**
 - B) Prishja e marrëdhënieve diplomatike mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë.
 - C) Shpallja e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në vitin 1974.
 - D) Ardha në krye të Jugosllavisë e Aleksandër Rankoviçit.
58. Cili nga shtetet perëndimore e njohu i pari qeverinë shqiptare të dalë nga zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945? **1 pikë**
- A) Franca;**
 - B) SHBA-ja;
 - C) Anglia;
 - D) Italia.
59. Me cilin nga vendet e mëposhtme Shqipëria shkëputi marrëdhëniet politike dhe ekonomike gjatë regjimit komunist, duke u izoluar përfundimisht nga bota? **1 pikë**
- A) Bashkimin Sovjetik;
 - B) Jugosllavinë;
 - C) SHBA-në;
 - D) Kinën;**
60. Cili prej pohimeve të mëposhtme ishte shkak për kolapsin ekonomik të sistemit komunist në Shqipëri? **1 pikë**
- A) Rritja e iniciativës ekonomike private në vitet '80.
 - B) Rritja e eksporteve të produkteve shqiptare.
 - C) Racionimi i ushqimit nëpërmjet tollonave.
 - D) Administrimi i centralizuar i ekonomisë.**